Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

THIRRJE PUBLIKE
për Organizatat Joqeveritare dhe Personat Fizikë / Profesionistët Individualë për Mbështetjen dhe Realizimin e Aktiviteteve në Kuadër të Programit të Mësimit Tërëditor

UDHËZIMET PËR APLIKANTËT

Data e hapjes së thirrjes: 5 Nëntor, 2026 | Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: 25 Nëntor, 2026

Përmbajtja

1. MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-VE DHE PERSONAVE FIZIKË PËR MËSIMIN TËRËDITOR
   1.1 PROBLEMET TË CILAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE PUBLIKE
   1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE
   1.3 VLERA E PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTALI I THIRRJES
2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES
   2.1 Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikojë?
   2.2 Partnerët e pranueshëm në zbatimin e projektit/programit
   2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes
   2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes
      2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme
      2.4.2 Shpenzimet e papranueshme
3. SI TË APLIKONI?

3.1 Forma përshkruese e projektpropozimit
3.2 Përmbajtja e formës së buxhetit
3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin?
3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve
3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?
4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE
4.1 Procedura e vlerësimit të aplikacioneve
4.2 Dokumentacioni shtesë dhe kontraktimi
5. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES
6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

1. MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-VE DHE PERSONAVE FIZIKË PËR MBËSHTETJEN DHE REALIZIMIN E AKTIVITETEVE NË KUADËR TË PROGRAMIT TË MËSIMIT TËRËDITOR

1.1 PROBLEMET TË CILAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE PUBLIKE

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në bazë të rregullores 01-011/01-79067/25 të datës 4.6.2025 për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës, si dhe në bazë të rregullores MF-NR-04/2027 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të, fton organizatat joqeveritare të regjistruara dhe personat fizikë / profesionistët individualë të regjistruar në Republikën e Kosovës që të aplikojnë me projekte për realizimin e aktiviteteve edukative dhe zhvillimore në kuadër të zbatimit të procesit të mësimit tërëditor në institucionet arsimore të Komunës së Prishtinës.

Qëllimi i kësaj thirrjeje është mbështetja e institucioneve edukativo-arsimore ku është duke u zbatuar procesi i mësimit tërëditor me aktivitete cilësore, të strukturuara dhe atraktive, të cilat plotësojnë procesin e rregullt mësimor dhe kontribuojnë në zhvillimin edukativ, social, emocional, kreativ dhe fizik të nxënësve.

1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE

Objektivi i përgjithshëm i kësaj thirrjeje është mbështetja e procesit të mësimit tërëditor përmes ofrimit të aktiviteteve cilësore dhe me vlerë të shtuar edukative për nxënësit e institucioneve arsimore të Komunës së Prishtinës.

Objektivat specifike dhe fushat prioritare për ndarjen e fondeve janë:

- **a) Teknologji dhe kompetenca digjitale:** Kodim dhe programim për fëmijë; robotikë edukative; shkathtësi digjitale dhe përdorim kreativ i teknologjisë; aktivitete edukative në fushën e STEM-it dhe inovacionit, të përshtatura sipas moshës dhe nivelit të nxënësve të klasave 1-5.
- **b) Sport dhe mirëqenie fizike:** Aktivitete sportive dhe rekreative; programe të notit; sporte ekipore dhe individuale; aktivitete për zhvillimin motorik, shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve.
- **c) Art, kulturë dhe kreativitet:** Art figurativ dhe punëtori kreative; muzikë dhe aktivitete instrumentale; teatër, dramë dhe aktivitete skenike; vallëzim dhe aktivitete kulturore.
- **d) Shkathtësi për jetë dhe zhvillim personal:** Komunikim dhe punë ekipore; zhvillim i kreativitetit dhe mendimit kritik; edukim socio-emocional; aktivitete për përgjegjësi, bashkëpunim dhe qytetari aktive.
- **e) Aktivitete edukative dhe mësim përmes përvojës:** Punëtori tematike dhe praktike; aktivitete shkencore dhe eksperimentale; aktivitete që ndërlidhin mësimin me situata praktike dhe jetën e përditshme; programe të tjera inovative që janë në funksion të objektivave të mësimit tërëditor.

Prioritet për ofrimin e mbështetjes financiare publike do të kenë OJQ-të dhe profesionistët individualë që propozojnë programe cilësore, atraktive dhe inovative, të konceptuara në përputhje me interesat dhe nevojat e nxënësve, si dhe që ofrojnë përmbajtje edukative me vlerë të shtuar në kuadër të programit të mësimit tërëditor në Komunën e Prishtinës.

1.3 VLERA PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTALI I THIRRJES

1. Për mbështetje financiare publike për projektet/programet sipas kësaj Thirrje publike është paraparë shuma në dispozicion prej 80,000.00 € (tetëdhjetë mijë euro).

2. Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për një OJQ në kuadër të kësaj thirrjeje publike shkon deri në shumën maksimale prej 20,000.00 € (njëzet mijë euro).

3. Shuma minimale që mund të ndahet për çdo projekt individual është minimum 600.00 € (gjashtëqind euro) për muaj, ndërsa shuma maksimale është 6,000.00 € (gjashtë mijë euro) për periudhën e caktuar projektuese.

2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

2.1 Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikojë?

Të drejtë aplikimi kanë organizatat joqeveritare dhe personat fizikë / profesionistët individualë të cilët:

- Janë të regjistruar në Republikën e Kosovës (për OJQ-të: të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi; për personat fizikë: të regjistruar konform kornizës ligjore).
- Të jenë të pajisur me Numër Fiskal të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).
- Të kenë kryer të gjitha detyrimet tatimore ndaj ATK-së dhe të kenë menaxhim transparent financiar.
- Kanë në statutin ose programin e tyre të punës veprimtari që lidhen me fushën për të cilën aplikojnë (arsim, teknologji, sport, art, kulturë, zhvillim i fëmijëve).
- Kanë përvojë të dëshmuar në realizimin e aktiviteteve me fëmijë dhe/ose nxënës.
- Kanë kapacitete profesionale dhe organizative për realizimin e projektit dhe dëshmojnë kualifikimet e personave që angazhohen drejtpërdrejt.
- Aplikuesi nuk është në procedurë të shuarjes, falimentimit apo çregjistrimit.
- Aplikuesi të mos ketë pranuar mjete nga burime të tjera të financimit për të njëjtat aktivitete (mungesa e financimit të dyfishtë).
- Të gjithë aplikuesit që i kanë përmbyllur me sukses projektet paraprake të mbështetura nga institucionet publike.
- Për aktivitetet që kërkojnë licenca, certifikime apo kualifikime specifike profesionale (si njoftimi për programe të notit, instruktazhe digjitale etj.), aplikuesi duhet të paraqesë dëshmitë përkatëse.

Numri i projekteve me të cilat mund të aplikojë një OJQ ose person fizik: Një aplikant mund të paraqesë vetëm një kërkesë/projekt-propozim në kuadër të kësaj thirrjeje.

2.2 Partnerët e pranueshëm në zbatimin e projektit/programit

Për zbatimin e projektit nuk është e detyrueshme ekzistenca e partneritetit me organizata të tjera apo profesionistë individualë, por e njëjta është e dëshirueshme. Në

rast të ekzistencës së partneritetit, partnerët duhet të përmbushin të gjitha kriteret e përshtatshmërisë si aplikuesi kryesor. Me rastin e aplikimit, duhet të dorëzohet Deklarata e Partneritetit e nënshkruar nga të gjithë partnerët në projekt.

2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

Projektet do të realizohen gjatë vitit shkollor 2026-2027, në përputhje me kalendarin e procesit mësimor dhe organizimin e programit të mësimit tërëditor, duke filluar nga muaji dhjetor 2026 deri më 23 qershor 2027.

Kushtet e aktiviteteve të pranueshme:

- Aktivitetet duhet të kryhen brenda territorit të Komunës së Prishtinës, në shkollat e përcaktuara nga Drejtoria e Arsimit ku zbatohet mësimi tërëditor.
- Përfitues të drejtpërdrejtë duhet të jenë nxënësit e klasave 1-5 të institucioneve arsimore të Komunës së Prishtinës.
- Aktivitetet duhet të realizohen në koordinim të plotë me Drejtorinë e Arsimit dhe institucionet arsimore përkatëse.
- Aktivitetet duhet të përshtaten me moshën dhe nevojat zhvillimore të nxënësve dhe të organizohen në grupe të menaxhueshme.
- Aktivitetet nuk duhet të zëvendësojnë mësimin e rregullt, por të jenë përforcues të procesit edukativo-arsimor.
- Aktivitetet duhet të promovojnë pjesëmarrjen aktive, gjithëpërfshirjen, kreativitetin dhe mirëqenien e nxënësve.

2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

Përmes fondeve publike të kësaj thirrjeje mund të financohen vetëm kostot reale, të nevojshme, të arsyeshme dhe të verifikueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit. Buxheti i propozuar duhet të jetë i ndërlidhur drejtpërdrejt me numrin e nxënësve, numrin dhe kohëzgjatjen e aktiviteteve, angazhimin e stafit profesional dhe materialet e nevojshme.

2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme

Shpenzimet direkte të pranueshme përfshijnë:

- Shpenzimet e kompensimit/pagave për trainerët, instruktorët, ligjëruesit dhe personelin profesional të angazhuar drejtpërdrejt në realizimin e aktiviteteve edukative, digjitale, sportive e artistike me nxënësit.
- Shpenzimet e materialeve të nevojshme punuese dhe edukative (kompletet e kodimit/robotikës, pajisjet sportive, materialet e artit figurativ, instrumentet apo rekuizitat për punëtori).
- Shpenzimet e organizimit të punëtorive tematike, aktiviteteve praktike, eksperimentale dhe vizitave mësimore/ekskurzioneve edukative lokale.
- Shpenzimet e transportit apo logjistikës që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e aktiviteteve të projektit (si transporti për programet e notit apo vizitat praktike).
- Shpenzimet e komunikimit dhe koordinimit të projektit.

2.4.2 Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë:

- Kostot që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me përmbajtjen dhe objektivat e projektit të mësimit tërëditor.
- Shpenzimet e interesit për borxhin, kamatat dhe gjobat financiare.
- Investimet kapitale, blerja e pronave apo kredive për investime.
- Pagesa e bonuseve apo shpërblimeve shtesë për punonjësit.
- Aktivitetet që përmbajnë çfarëdo forme të diskriminimit apo që nuk zhvillohen në Komunën e Prishtinës.

3. SI TË APLIKONI?

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe dokumentacionin përcjellës si vijon:

- Formularin e aplikimit / projekt-propozimit (të plotësuar me kompjuter);
- Propozim-buxhetin e detajuar të projektit (i ndërlidhur me numrin e nxënësve dhe angazhimin e stafit);
- Planin e detajuar të aktiviteteve dhe dinamikës së punës;
- Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së apo regjistrimit të personit fizik/profesionistit individual;
- Certifikatën e Numrit Fiskal nga ATK;
- Statutin e organizatës (për OJQ-të);

- Formën e deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë;
- Certifikatën nga ATK për gjendjen e borxhit tatimor (aplikuesit duhet të kenë kryer obligimet tatimore para nënshkrimit të kontratës);
- Dëshminë se aplikuesi nuk është nën falimentim ose administrim të dhunshëm gjyqësor (lëshuar nga Gjykata Themelore, origjinali jo më i vjetër se 30 ditë);
- Dëshminë e xhirollogarisë aktive bankare në njërën nga bankat e licencuara në Kosovë;
- Kopjen e letërnjoftimit të përfaqësuesit të autorizuar / personit fizik;
- CV-të dhe dëshmitë e kualifikimit profesional të personelit kyç që do të angazhohet drejtpërdrejt në aktivitete;
- Dëshmitë mbi përvojën relevante në realizimin e projekteve apo aktiviteteve me fëmijë dhe/ose nxënës;
- Licencat, certifikimet apo kualifikimet specifike profesionale (për aktivitete që e kërkojnë atë sipas ligjit).
- Formularin e Deklaratës së Partneritetit (në rast se aplikohet në partneritet).

3.1 Forma përshkruese e projektpropozimit

Plotësimi i formularit të projekt-propozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ai duhet të përmbajë të dhëna të qarta mbi metodologjinë e punës me nxënës, përputhshmërinë me fushat prioritare të mësimit tërëditor, si dhe rezultatet e matshme. Forma duhet të plotësohet vetëm me kompjuter (aplikimet me dorë refuzohen).

3.2 Përmbajtja e formës së buxhetit

Formulari i propozim-buxhetit duhet të përmbajë informacion të detajuar për të gjitha shpenzimet e projektit. Buxheti duhet të pasqyrojë kosto reale, të arsyeshme dhe të verifikueshme, të ndërlidhura me numrin e nxënësve përfitues dhe kohëzgjatjen e aktiviteteve (minimum 600 €/muaj deri në maksimum 6,000 € gjithsej për projekt).

3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin?

Format e detyrueshme dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të dorëzohen në kopje fizike në zarf të mbyllur zyrtar.

Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike, emri i plotë dhe adresa e aplikuesit, si dhe shënimi: 'Të mos hapet para mbledhjes së Komisionit Vlerësues'.

Aplikacionet duhet të dorëzohen personalisht apo me postë në adresën e mëposhtme:

Komuna e Prishtinës
Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA)
Rr. 'UÇK' nr. 2, 10000, Prishtinë
Qendra për Shërbime me Qytetarë (Objekti i vjetër i Komunës)
Kati përdhese, Sporteli nr. 5
'Të mos hapet para mbledhjes së Komisionit Vlerësues'

3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

Afati i thirrjes publike është 15 ditë pune nga data e hapjes, respektivisht nga data 04 Nëntor 2026 deri më 24 Nëntor 2026. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar ose që nuk i plotësojnë kushtet e thirrjes nuk do të merren parasysh.

3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

Të gjitha pyetjet dhe kërkesat për sqarime lidhur me këtë thirrje publike mund të parashtrohen vetëm në mënyrë elektronike duke dërguar e-mail në adresën zyrtare:

E-mail: kryeqyteti.arsimi@rks-gov.net

4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

4.1 Procedura e vlerësimit të aplikacioneve

Aplikacionet e pranuara do të kalojnë nëpër dy faza të vlerësimit nga Komisioni Vlerësues i themeluar nga Komuna e Prishtinës:

1. Shqyrtimi administrativ dhe formal: Kontrollimi nëse aplikacioni përmban të gjitha dokumentet e kërkuara dhe plotëson kushtet formale.

2. Vlerësimi përmbajtësor i projekteve: Projektet do të vlerësohen sipas 10 me kriteret kryesore të mëposhtme:

- 1. Relevanca e projektit me qëllimin e mësimit tërëditor;
- 2. Cilësia dhe inovacioni i aktiviteteve të propozuara;

- 3. Përvoja dhe kapacitetet profesionale të organizatës / aplikuesit;
- 4. Kualifikimi dhe përvoja e stafit të angazhuar;
- 5. Numri i nxënësve që do të përfitojnë;
- 6. Metodologjia e punës me nxënës;
- 7. Rezultatet dhe ndikimi i pritshëm;
- 8. Realizueshmëria e planit të aktiviteteve;
- 9. Qëndrueshmëria dhe mundësia e përsëritjes së aktivitetit;
- 10. Arsyeshmëria dhe efikasiteti i buxhetit të propozuar.

4.2 Dokumentacioni shtesë dhe kontraktimi

Pas përfundimit të vlerësimit, Komisioni do të publikojë listën e përkohshme të projekteve të përzgjedhura. Aplikuesit në listën e përkohshme do të ftohen të dorëzojnë dokumentacionin shtesë verifikues (nëse kërkohet) brenda afatit prej 10 ditësh para nënshkrimit të kontratës përfundimtare.

5. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES

• Hapja e thirrjes publike: 05 Nëntor 2026
• Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve: 17 Nëntor 2026
• Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: 25 Nëntor 2026
• Vlerësimi i aplikacioneve dhe publikimi i rezultateve: Nëntor 2026
• Faza e kontraktimit dhe fillimi i zbatimit të projekteve: Muaji Dhjetor 2026 deri më 23 Qershor 2027.

6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

Formularët zyrtarë për aplikim janë të disponueshëm për shkarkim në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës (https://prishtinaonline.com):

- Formulari i Aplikacionit për projekt/program (projekt-propozimi);
- Formulari i Propozim-Buxhetit;
- Formulari i Planit të Aktiviteteve;
- Formulari i Deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë;
- Formulari i Deklaratës së projekteve të financuara nga burimet publike;
- Formulari i Deklaratës së Partneritetit (nëse zbatohet në partneritet);
- Formulari i Raportit Financiar dhe Raportit Narrativ (për fazën e raportimit).